

## **AKT THEMELIMI**

### **Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ANKA MARIN TECNICAL” SH.P.K.**

Sot, më datën 29.06.2023, **Z. MEVLUT YAMAN** i lindur në Cide, Turqi me datë 10 gusht 1967, mbajtës i pashaportes me numër U27561278, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. APTI MERT KOÇER**, i lindur në Marmaris, Turqi me datë 17 tetor 2002, mbajtës i pashaportes me numër U26859121 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ANKA MARIN TECNICAL” Sh. P. K. si më poshtë vijon

#### **Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “ANKA MARIN TECNICAL”.

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Z. Mevlut YAMAN**, **Z. APTI MERT KOÇER**.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Mevlut YAMAN** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

#### **Neni 2**

Shoqëria “ANKA MARIN TECNICAL” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “ANKA MARIN TECNICAL” SH.P.K. është : **Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 24/128-ND+1-27, Durrës.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

#### **Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

#### **Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Prodhim dhe montim të mjeteve lundruese
- Shërbime riparimi të mjeteve lundruese
- Tregetim i mjeteve lundruese
- Import-Export i pajisjeve detare

## Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 10000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

**Z. Mevlut YAMAN** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Apti Mert KOÇER** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre ( pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta ). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

## Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

## Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

## Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

## Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organinzimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

## ORTAKET E SHOQERISE

**Z. Mevlut YAMAN**

**Z. Apti Mert KOÇER**